

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

***Observatori i reformave në media***

**Raport periodik  
nga vëzhgimi i përmbushjes së reformave prioritare  
nga fusha e mediave**

Periodha e raportimit: 01.05.2020 – 15.08.2020

Ky raport është rezultat i procesit të vëzhgimit të zbatimit të reformave prioritare (RUP) nga fusha e mediave në kuadër të projektit “Observatori i reformave në media”, të cilin e implementon Fondacioni “Metamorfozis”. Projekti mbështetet nga Fondacioni Shoqëri e Hapur në Maqedoni (FSHHM). Në fazën e parë të tij, u implementua në periudhën 01.07.2017 deri më 30.09.2018 kur edhe u inicua ky projekt nëpërmes vëzhgimit të implementimit të RUP nga fusha e mediave.

Të gjitha materialet që kanë të bëjnë me këtë projekt dhe me vëzhgimin e zbatuar, mund t’i gjeni në faqen e internetit të dizajnuar vetëm për nevojat e projektit.

Web – adresa : <http://mediaobservatorium.mk/sq/>

Qershor - 2020

Përmbajtja dhe teksti janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron qëndrimet e Fondacionit “Shoqëri e Hapur – Maqedoni”.

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

## **Observatori i reformave në media**

### **Përmbajtja**

Përmbledhje e shkurtër.....	3
Hyrje.....	5
Qëllimet dhe metodologjia e vëzhgimit.....	7
Qëllimi dhe metodat e raportit.....	7
Hulumtim.....	8
Konstatimet kyçe nga vëzhgimi.....	10
1. Shërbimi publik radiodifuziv dhe reformat në media.....	10
1.1 Zgjedhjet e parakohëshme parlamentare.....	12
2.Reklamimi qeveritar/ paratë publike në media.....	14
3. Qasja te informatat.....	15
3.1 Shpifja .....	16
Literatura e shfrytëzuar.....	17

### **Shkurtesat**

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut  
BE – Bashkimi Evropian  
KE – Komisioni Evropian  
RUP – Reformat urgjente prioritare; reformat prioritare  
GJEDNJ – Gjyqi European për të Drejtat e Njeriut  
ASHAAM – Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike  
ORM – Observatori i Reformave në Media  
SHGM – Shoqata e gazetarëve në Maqedoni  
KSHPK – Komisioni Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit  
SPGPM – Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik në Maqedoni  
KSHZ – Komisioni Shtetërorë Zgjedhorë  
NP RDM – Radiodifuzioni i Maqedonisë  
IZHKE- Instituti për Zhvillim të Komunikimeve Elektronike

**Fjalët kyçe** Media-vëzhguese, media-vëzhgim, reformat prioritare (urgjente), Pribe, mediat, shërbimi publik radiodifuziv, reklamimi qeveritar, qasja te informatat, shpifja, Reformat në media.

**Vërejtje** Teksti është përgatitur në kuadër të projektit “Observatori i Reformave në Media”, të cilin e realizon Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, me mbështetje financiare të “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”. Përmbajtja e tekstit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e “Fondacionit Shoqëri e hapur – Maqedoni”.

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### *Observatori i reformave në media*

## Përmbledhje e shkurtër

Ky raport periodik i prezanton rezultatet e përgjithëshme nga vëzhgimi i përmbushjes së reformave urgjente prioritare (RUP) që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit, në periudhën **1 maj 2020 deri më 15 gusht 2020** në kuadër të projektit “Observatori i reformave në media” të cilin e realizon Fondacioni për internet dhe shoqëri “Metamorfozis”, me mbështetje financiare nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Vëzhgimi, objekt i të cilit ishin katër shtyllat e RUP, verifikoi këto gjetje kyçe:

- **Shërbimi publik radiodifuziv dhe reformat në media** – në RTM edhe në këtë periudhë vëzhgimi, munguan reformat thelbësore të cilat do ta shndërronin në shërbim të vërtetë të qytetarëve. Rregullorja e miratuar për sistematizimin e RTM-së e vërtetoi nevojën për mbindërtim kadrovik. Edhe pse ky sistematizim është miratuar nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA) nuk ka paralajmërime për përforsim financiar të shërbimit publik radiodifuziv. Prandaj, në veçanti brengos paralajmërimi i udheheqësisë së RTM-së se deri në fund të vitit 2020 nuk kanë mundësi të punësojnë kuadër të ri për arsye të rënies së vazhdueshme të të ardhurave. Duke mos i siguruar mjetet e nevojshme buxhetore për RTM-në, shteti nuk e përmbush rekomandimin e KE-së. Mbetet e paqartë se si RTM paraqet realizim të rezultateve financiare pozitive për çerekun e parë dhe të dytë të vitit 2020, ndërkohë që buxheti shtetërorë është burimi kryesorë financiar, ndërsa udheheqësia deklaron se mjetet nga buxheti nuk janë të mjaftueshme për funksionim normal të shërbimit publik radiodifuziv. Aktivitete e filluara dhe përgatitjet për zgjedhjet e parakohëshme parlamentare si dhe ndjekja e tyre, rezultuan me Regulla për Përfaqësim Mediatik në shërbimin e parë programor të televizionit. Në vlerësimet e misioneve relevante monitoruese RTM u vlerësua se i është përmbajtur Kodit Zgjedhor me përpikmëri. Raportet monitoruese të publikuara nga organizata mediatike ndërkombëtare shënojnë përparim në fushën mediatike për të cilin OJQ-të mediatike vendore deklarojnë se ai është më shumë sukses i tyre se sa i qeverisë.
- **Reklamimi qeveritar/ paratë publike në media** – si përgjigje për menaxhimin e pasojave ekonomike nga kriza me Korona virusin, qeveria ndau ndihmë shtetërore edhe për radiodifuzerët nacional njësoj si edhe për subjektet komerciale. Më tej, ajo e urdhëroi NP RDM që të mos iu faturojë harxhime për furnizim energjetik të pajisjeve radiodifuzive si dhe harxhimet për qirra të hapësirave për vitin 2020. Për më tepër qeveria i subvencionoi kontributet për të gjithë të punësuarit në media për muajt qershor, korrik dhe gusht të vitit 2020.

E filluar por e  
perealizuar

Pjesërisht e  
realizuar

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### ***Observatori i reformave në media***

- **Qasja te informatat** – Edhe pse nga aspekti metodologjik kjo shtyllë llogaritet tërësisht e realizuar, përshkak të miratimit të ligjit të ri dhe formimit të trupit regullator qytetarët përsëri përballen me heshtje nga institucionet edhe në këtë periudhë të vëzhgimit të rethanave në këtë fushë. Për heshtje të institucioneve ankohen edhe punëtorët mediatik të cilët merren me gazetari hulumtuese por edhe Shoqata e Gazetarëve në Maqedoni (SHGM). Indeksi për transparencë aktive i përpiluar nga Qendra për Komunikime Qytetare (QKQ) tregon se te ministrinë është zvogëluar koha e pritjes në mënyr progresive që nga viti 2018. Ndërkohë, te komunat koha e pritjes po zgjatet. Megjithatë, në bazë të matjeve është konstatuar se institucionet e tejkalojnë afatin njëzet ditorë të përcaktuar me ligj për përgjigje ndaj kërkesave për qasje te informatat. Vet Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë deri te Informatat me Karakter Publik gjatë vlerësimit të transparencës së institucioneve ka konstatuar përsëri se arsyeja kryesore për pamundësinë e qasjes te informatat është [“heshtja e menaxhmentit”](#).<sup>1</sup>
- **Shpifja dhe ofendimi** – edhe pse në periudhën e vëzhgimit paraprak nga Ministria e Drejtësisë u parajlemruan aktivitete fillestare në drejtim të përmirësimit të Ligjit për Përgjegjësi Qytetare për Shpifje dhe Ofendim, në këtë periudhë nga ministria informuan se për arsye të krizës globale me Korona- virusin, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektsh (ZKBSHP) e ka anuluar përpilimin e analizës për zbatimin e Ligjit për Përgjegjësi Qytetare për Spifje dhe Ofendim deri në fund të shtatorit.  
Observatori i Reformave në Media 2 (ORM2) do të vazhdojë me ndjekjen e përbushjes së reformave urgjente në media nga 15 gusht deri 31 dhjetor të vitit 2020, duke i prezantuar rezultatet në formën e raporteve periodike, lajmeve dhe storjeve hulumtuese, me qëllim të kyçjes sa më të madhe të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në proceset demokratike. Të gjitha rezultatet nga vëzhgimi mund ti gjeni në gjuhën maqedonase dhe shqipe në web – lokacionin [MediaObservatorium.mk](#).

Tërësisht i realizuar

E filluar por e porealizuar

<sup>1</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/arsyeja-kryesore-per-te-mos-pasur-qasje-ne-informacione-eshte-heshtja-e-administrates/>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

## **Observatori i reformave në media**

### **Hyrje**

Fill pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përzhinës, Komisioni Evropjan përgatiti dokument të posatshëm me reformat prioritare për Maqedoninë (**Urgent Reform Priorities – Reformat Urgjente Prioritare - RUP**)<sup>2</sup>, të cilat vendi duhet ti përmbush në fushën e sundimit të së drejtës, depolitizimit të administratës publike, lirisë së të shprehurit dhe reformës zgjedhore. **Reformat Urgjente Prioritare (RUP)** është dokument i cili ndërlidhet me raportin e grupit të ekspertëve të udhëhequr nga **Rajnhard Pribe**<sup>3</sup>. Ai është i ndarë në pesë kapituj: Sundimi i së drejtës dhe gjyqësija; Depolitizimi i administratës publike; Reforma zgjedhore; Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Anketues për ngjarjet e 24 dhjetorit; Mediat: lirija e të shprehurit. Në pajtueshmëri me negociatat për arrijten e Marrëveshjes së Përzhinës por shprehimisht edhe me reformat prioritare, reformat në sferën e mediave dhe lirisë së të shprehurit janë të një rëndësie thelbësore për zhvillimin e një pushteti të lirë, transparent dhe demokratik në vend. Konkretisht, reformat në fushën “Mediat: lirija e të shprehurit” kanë për qëllim që të arrihet përparim dhe të zgjidhen problemet në katër sfera: **shërbimi publik radio-difuziv, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe rregullativa për shpifje dhe ofendim**.

Me ndërimin e kontekstit në vitin 2017, posaçërisht pas konstituimit të pushtetit të ri legjislativ dhe ekzekutiv, pritej që reformat e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga grupet e ekspertëve, të implementohen me ritëm të përshpejtuar. Për fat të keq, pritshmëritë për shpejtësinë dhe shtrirjen e aktiviteteve reformuese nuk u realizuan, edhe pse kishte lëvizje në disa nga katër sferat e RUP. Kjo mund të konstatohet edhe nga raporti final i **RUP nga viti 2018**<sup>4</sup> i cili u publikua në tetor të vitit 2018 dhe kishte të bëjë me periudhën nga 01.07.2017 deri më 30.09.2018.

Në periudhën nga tetori i vitit 2018 deri më nëntor të vitit 2019 nuk ndodhën ndryshime të konsiderueshme dhe avansim i reformave konform RUP të Rajnhard Pribe në sferën “Liria e të shprehurit” dhe katër shtyllat e tij. Aktivitetet e vetme reformuese u bënë në sferën “Liria e qasjes te informatat me karakter publik” me ndryshimin e ligjit, Agjencisë së re të formuar për këtë qëllim dhe emërimit të personave udhëheqës në të nga ana e Kuvendit.

Konteksti i ndryshuar politik dhe mediatik paraqiti nevojën për ndryshimin e shtrirjes së vëzhgimit dhe solli te riemërimi, gjegjësisht shtimin e nënsferave të reja për vëzhgim.

- Reklamimi qeveritar (e emëruar sipas Pribe) u zgjërua në vëzhgimin e harxhimit të parave publike në media nga ana e institucioneve publike në nivel lokal dhe shtetërorë, duke patur parasyshë faktin se qeveria e ndërpreu praktikën e reklamimit të saj në media;
- Për shërbimin publik radio-difuziv u tregua se nuk mund të ndiqet vetëm ai pa mos u ndjekur: gjendja në legjislacionin mediatik, ministria kompetente dhe ndryshimet eventuale që kanë të bëjnë me trupat udhëheqëse rregullatore në media të cilët i krijojnë politikat mediatike.

<sup>2</sup> Reformat urgjente prioritare – përkthim në gjuhën maqedonase:

[https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_mk.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf). Në origjinal në gjuhën angleze: Urgent Reform Priorities for Macedonia, Komisioni Evropjan, DGJ Politika për fqinjësi të mirë dhe negociatat për zgjerim, qershor 2015  
[https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_en.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf)

<sup>3</sup> Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

<sup>4</sup> [http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2018/11/OMR\\_završen\\_izveshtaj1-alb.pdf](http://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2018/11/OMR_završen_izveshtaj1-alb.pdf)

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### ***Observatori i reformave në media***

Zgjerimi i tillë i shtrirjes së fushave për vëzhgim (dhe të vet rethanave brenda tyre) nuk i ndryshoi qëllimet dhe metodologjinë e vëzhgimit në katër fushat kyqe të cilat u shfaqën të rrëndësishme të jashtëzakonshme dhe janë njëri nga treguesit e nivelit të zhvillimit dhe të demokratizimit të lirisë së të shprehurit, e njëkohësisht edhe për demokratizimin e shoqërisë në përgjithësi.

Periudha e fundit e ndjekjes së rethanave në RUP në fushën “Mediat: Liria e të shprehurit” u ballafaqua me disa sfida të cilat e okupuan kontekstin e vendit, hapësirën publike dhe politike dhe rjedhimisht me këto sfida ndryshohej fokusi në vet sektorin mediatik.

Kriza shëndetësore e shkaktuar nga pandemia me Korona-virusin i përfshiu të gjitha sektoret e jetës shoqërore; zgjedhjet e parakohëshme parlamentare të cilat ishin caktuar në mars të vitit 2020, për shkak të epidemisë u shtynë në 15 korrik 2020. Këto dy rethana të reja nga njëra anë kërkonin mobilizim, ndërsa nga ana tjetër respektim të përpiktë të masave shëndetësore me çka u vështirësua komunikimi, ndjekja dhe raportimi për rethanat në fushën mediatike në këtë periudhë. Prolongimi i datës së zgjedhjeve parlamentare u reflektua edhe në afatet e periudhës së monitorimit dhe raportimit sepse pritej që dinamika e konstituimit të institucioneve relevante do të mundet të ndiqet edhe në këtë çerekviti. Si pasojë periudha e monitorimit u prolongua për dy javë, gjegjësisht deri në 15 gusht 2020.

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### *Observatori i reformave në media*

## **Qëllimi dhe metodologjia e vëzhgimit**

### *Qëllimi dhe metodat e raportit*

Ky raport është i paraparë para së gjithash për informimin e publikut në përgjithësi ose të qytetarëve për procesin e përmbushjes së RUP **nga fusha e mediave**, në mënyrë të kuptueshme, i përshtatur për publikun e gjërë dhe publikun joekspertiv. Për më tepër, raporti i informon edhe palët e tjera të interesuara: mediat, institucionet dhe sektorin civil.

Raporti ka për qëllim të sigurojë informata relevante për progresin e zbatimit të reformave të parapara në fushën e mediave.

Ky raport është i përgatitur në pajtueshmëri me një metodologji të zhvilluar posaçërisht për vëzhgim e cila përfshinë një sërë aktivitetesh dhe masash për mbledhjen e të dhënave dhe për ndjekjen e proceseve të reformave. Metodologjia bazohet në zbatimin e një sërë aktivitetesh hulumtuese duke filluar nga analiza e kornizës ligjore aktuale dhe gjendjes në fushën e mediave dhe lirisë së të shprehurit, zbatimi i vëzhgimit ditorë dhe periodic dhe analiza hulumtuese, organizim i fokus-grupeve me persona kyq të informuar dhe të ngjashme.

**Desk-hulumtimi** është i fokusuar në mbledhjen e informative dhe në analizën e të gjitha dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me përmbushjen e RUP në fushën e mediave, si që janë raportet vjetore të BE-së për Maqedoninë, raportet e Pribesë, si dhe dokumentet dhe raportet e institucioneve nacionale ose organizatave që kanë të bëjnë me reformat prioritare në media. Këto të dhëna sigurohen nga kanale të ndryshme të informatava duke i përfshirë edhe ato nga rrjetet e bashkëpunëtorëve në sektorin civil dhe mediatik, si dhe nga vet institucionet përmes Ligjit për qasje të lire deri te informatat me karakter publik.

Për ndjekje më të mire dhe të vazhdueshme të gjendjes së përmbushjes të reformave në media, në kuadër të projektit zbatohen aktivitete të **vëzhgimit ditorë dhe periodik** të ueb-faqeve relevante me përmbajtje lidhur me reformat në media.

Aktivitetet e projektit përfshinë zbatimin e mbledhjeve të dy **fokus-grupeve** që të meren informata nga persona kyq të informuar dhe ekspert nga fusha të lidhura me përmbushjen e RUP nga sektori civil, akademik, privat dhe qeveritar. Njohuritë nga fokus-grupi i parë nga mbledhja e mbajtur në dhjetor të vitit 2019, janë të ngërthyera në rezultatet nga vëzhgimi dhe shërbyen si kahëzim për aktivitetet e mëtutjeshme për vëzhgim dhe hulumtime gazetareske.

Për prezentimin e gjetjeve nga vëzhgimi dhe për të nxitur dialog më të gjërë mes politikbërësve dhe aktivistëve të tjerë ose publikut, parashihen **dy debate publike**, të cilat kanë për qëllim të përfshinë shoqërinë civile në këto procese.

Rezultatet nga vëzhgimi janë të publikuara në formë të **analizave periodike (çerekëshe) dhe analizës përmbyllëse**. Në nivel të projektit, këto informata do të plotësohen me **artikuj analitik/hulumtues**, nëpërmes të cilëve qytetarëve do t'iu prezentohen njohuri plotësuese për kontekstin, gjendjen paraprake që solli te situata momentale, si dhe obligimet e ndërmara nga institucionet e RMV për të përmbushur reformat prioritare.

Vëzhgimi në periudhën mes 01.11.2019 dhe 30.10.2020 zbatohet nga ana e një ekipi multidisiplinor të projektit, i përbërë nga anëtarë të implementuesit Fondacioni "Metamorfozis" dhe tre projektet e tij mediatike Meta.mk; Portalb.mk dhe Vërtetmatës.mk me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspertë mediatik dhe jurist).



Projekti është i financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### **Observatori i reformave në media**

Sipas metodologjisë, aktivitetet ulumtuese verifikojnë katër nivele të realizimit të detyrave që dalin nga RUP në fushën “Mediat: lirija e të shprehurit”. Ato katër nivele janë:

1. Tërësisht e porealizuar – asgjë konkrete nuk ka filluar.
2. E filluar, por e porealizuar – me aktivitete të filluara për ndryshimin e legjislativës.
3. Pjesërisht e realizuar - ndryshime ligjore të zbatuara, pa implementim të filluar.
4. Tërësisht e realizuar – reformat janë të zbatuara në tërësi.

Gjatë pasqyrimin visual për komunikim me të lehtë me publikun e gjërë shfrytëzohen kode me ngjyra për çdo nivel të verifikuar të realizimit (e kuqe, portokalli, e verdhë dhe e gjelbërt).

1. Tërësisht e porealizuar – asgjë konkrete nuk ka filluar.	
2. E filluar, por e porealizuar – me aktivitete të filluara për ndryshimin e legjislativës.	
3. Pjesërisht e realizuar - ndryshime ligjore të zbatuara, pa implementim të filluar.	
4. Tërësisht e realizuar – reformat janë të zbatuara në tërësi.	

Foto 1: Niveli i realizimit dhe kodet me ngjyra

Aktivitetet e vëzhgimit të gjendjes i zbaton ekipi multidisiplinarë I projektit I përbërë nga anëtarë nga tre organizatat partnere me ekspertizë komplementare (gazetarë, ekspert mediatik dhe jurist).

### **Hulumtim**

Reformat prioritare nga sfera “Mediat: lirija e të shprehurit” parashohin një sërë masash konkrete dhe aktivitete që institucionet relevante në vend duhet t’i ndërmarrin me qëllim të arritjes së avansimit kah demokratizimi dhe qeverisja e mirë. Këto masa dhe aktivitete janë të ndara në katër shtylla të **zbatimit të reformave të parapara në fushën e mediave: Shërbimi publik radio-difuziv, reklamimi qeveritar, qasja te informatat dhe shpifja**. Në kuadër të çdo shtylle parashihen aktivitete plotësuese që kontribuojnë në përmbushjen e qëllimit të shtylles kryesore, gjegjësisht liri të të shprehurit të avansuar me respektimin e të gjitha vlerave demokratike i cili është në kuadër të dokumentit RUP të Pribes. Sipas RUP reformat që duhet të përmbushen në këtë fushë janë:

**Shërbimi publik radio-difuziv:** të sigurohen prova të dukshme për reforma në shërbimin publik radio-difuziv ne aspektin e politikës së të punuarit, organizimit, edukimit dhe redaktimit dhe mungesës së pavarësisë politike, mungesës së informimit të balansuar, si dhe sigurimin e përmbajtjeve informative me kualitet të lartë.

**Reklamimi qeveritar (paratë publike ne media):** të vendosen rregulla të rrepta për reklamim qeveritar të bazuar në kritere transparente, objective dhe jodiskriminuese; të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar dhe të zhvillohet mekanizëm për publikime pa pagesë në shërbimin publik të cilat me të vërtetë janë me interes publik.

**Qasja te informatat:** të adresohen pengesat kryesore me të cilat përballen gazetarët gjatë marrjes së informative publike.





Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### ***Observatori i reformave në media***

**Shpifja:** Zvogëlimi i numrit të rasteve të shpifjes përmes revidimit të legjislativës, të rregullave procedurale, përkrahjes dhe promovimit të shfrytëzimit më të madh të vetregullimit si alternativë e procedurimit gjyqësorë dhe garantim dhe zbatim. Në nivelin politik të praktikohet vetkufizim i përshtatshëm nga ana e politikanëve dhe funksionarëve publik për të mos inicuar procedime për shpifje, në pajtueshmëri me parimet e Gjyqit Evropjan për të Drejtat e Njeriut.

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni


## Observatori i reformave në media

### Konstatimet kyçe nga vëzhgimi

E filluar por e  
perealizuar

#### 1. Shërbimi publik radiodifuziv dhe reformat në media

Në kuadër të shtyllës së parë të RUP në sferën e mediave, janë dhënë rekomandime të qarta:  
„Të sigurohen dëshmi të qarta për reformat aktuale në shërbimin publik radiodifuziv nga aspekti i politikës së punës, organizimit, edukimit dhe redaktimit, të cilat kanë për qëllim angazhimin rreth kritikave që janë theksuar rregullisht në të kaluarën në lidhje me mungesën e pavarësisë politike, mungesës së raportimit të balancuar, si dhe sigurimit të përmbajtjeve informative, me cilësi të lartë.”



Në periudhën e vëzhgimit nuk pati reforma më të rëndësishme në shërbimin publik. Me Regulloren<sup>5</sup> për sistematizimin e RTM-së, përsëri u konstatuan nevoja për mbindërtim kadrovik, posaçërisht me kuadër gazetaresk i cili është bartës i veprimtarisë së RTM.

Nëse meret parasysh fakti se RTM është i vetmi shërbim publik në Europë i cili emiton program në shtatë gjuhë dhe pikërisht te redaksitë jomaqedonase është deficieti më i madhë i kuadrit gazetaresk, atëherë vërtetohen konstatimet dhe kërkesat e drejtuesëve për punësim të kuadrove të tjera teknike dhe gazetareske.

Analizat gazetareske<sup>67</sup> dhe publiku profesional potencojnë se përkrah mungesës së gazetarëve te redaksitë më të vogla etnike, ka nevojë për kuadër edhe në redaksitë për ueb, online dhe rrjetet sociale, derisa gjithsej 15 gazetarë mungojnë edhe në rrjetin e korespondentëve të RTM nga brendësia e vendit. Edhe pse sistematizimi i ri i RTM<sup>8</sup> nga ana e MSHIA, nga atje nuk paralajmërojnë përforcim financiar të shërbimit radiodifuziv. Për këtë arye posaçërisht brengos paralajmërimi i udhëheqësisë së RTM-së se deri në fund të vitit 2020 nuk do të kenë mundësi të punësojnë kuadër të ri për shkak të rënies së vazhdueshme të të ardhurave. Me mossigurimin e mjeteve të nevojshme buxhetore për RTM, shteti nuk e përmbush Rekomandimin e Këshillit Europian<sup>9</sup> i cili parasheh detyrimin e

<sup>5</sup> <http://mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%BD%D0%B8%D0%BA%20%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%88%D0%A0%D0%9F%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2%20%D0%B0%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BB-2020.pdf>

<sup>6</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/rtm-paska-nevoje-edhe-per-469-punonjes-tjere-aktualisht-jane-te-punesuar-755-persona-infografik/>

<sup>7</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/rtm-duhet-te-punesoje-me-shume-gazetare-te-hape-qendra-korrespondence-ne-vend-dhe-rajon/>

<sup>8</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/mshia-aprovoi-sistematizimin-per-460-vende-shtese-te-punes-ne-rtm/>

<sup>9</sup> <https://rm.coe.int/168050c770>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### **Observatori i reformave në media**

qeverive të sigurojnë sistem stabil financiar për shërbimet publike, si njëra nga shtyllat kryesore të autonomisë institucionale dhe politikës së pavarur redaktuese.

Nga ana tjetër, të dhënat zyrtare për të hyrat e RTM-së për çerekun e parë<sup>10</sup> dhe të dytë<sup>11</sup> të këtij viti tregojnë se shërbimi publik ka realizuar rezultat pozitiv financiarë në gjashtë muajt e parë të vitit 2020 edhe pse të hyrat nga buxheti shtetërorë edhe më tej mbeten burimi kryesor i financimit dhe ka punuar me ekipim kadrovik nën mesatare.

Në periudhën e vëzhgimit u publikuan dy raporte në të cilat janë ndjekur rethanat në media nga të renomuarat “Freedom House”<sup>12</sup> dhe nga “Reporterë pa kufij”<sup>13</sup>. Në raportin e “Freedom House” është shënuar përparim<sup>14</sup> në sektorin mediatic, pavarësia e të cilit këtë vit është vlerësuar me 3,5. Megjithatë, vlerësimi i tillë nuk është i favorshëm sepse më posht të ranguara janë vetëm lufta me korupcionin dhe pavarësia gjyqësore në Maqedoninë e Veriut. Edhe përkrah përparimit të konstatuar Maqedonia e Veriut mbetet në grupin e vendeve me regjime hibride tranzitore që do të thotë se institucionet demokratike janë të brishta dhe egzistojnë sfida të rëndësishme që kanë të bëjnë me të drejtat politike dhe liritë qytetare.

Raporti i “Reportere pa kufij” shtetin e rangon në vendin e 92-të që në krahasim me vitin e kaluar (vendi i 95-të) është përparim për 3 vende. Në raport vlerësohet pozitivisht edhe puna e organizatave gazetareske dhe mediaticke nëpërmjet përforsimit të sistemit të vetregullimit në media dhe përmirësimin e të drejtave sociale të gazetarëve. Raportin e tillë qeveria në komunikatën<sup>15</sup> e vet e përshkruan si sukses të tyre, në çka me reagim<sup>16</sup> të ashpër kundërshtuan nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatic (SPGPM) përshkak të mënyrës me të cilën qeveria e interpreton raportin e “Reportere pa kufij” duke i përvetësuar sukseset e organizatave gazetareske. Nga SPGPM mohojnë se në raport përmendet përmirësimi i të drejtave të punëtorëve të gazetarëve dhe punëtorëve mediatic, por, e përshëndesin përgatitjen e Kartës për kushtet e punës së gazetarëve dhe draft fer kontratat për punësim të gazetarëve dhe punëtorëve mediatic në mediat digjitale nga SPGPM, në bashkëpunim me organizatat tjera gazetareske. Edhe pse qeveria dhe SPGPM u ndanë<sup>17</sup> në lidhje me këtë raport, megjithatë sindikata e përshëndeti vendimin e qeverisë për masat ekonomike gjatë koronakrizës të cilat vlejnë edhe për mediat.

Enti shtetërorë për statistika (ESHZ) kumtoi<sup>18</sup> se 12 muajt e kaluar ka patur zvogëlim të subjekteve mediaticke, gjegjësisht, në vend kanë ndërprerë punën 11 radiostacione dhe shtëpi televizive. Analizat gazetareske<sup>19</sup> të të dhënave nga ESHZ tregojnë rënie të produktionit të programit të mediat radiodifuzive.

Fundi i qershorit të vitit 2020 u shënuar nga konflikti mes operatorëve kablovik dhe qeverisë përshkak të

<sup>10</sup> <http://mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%BE%D1%82%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%9A%D0%B5%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2%20%D0%B2%D0%BE%20%D0%BF%D0%B5%D1%80%D0%B8%D0%BE%D0%B4%20%D0%BE%D0%B4%2001.01.-31.03.2020%D0%B3.pdf>

<sup>11</sup> <http://mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%BE%D1%82%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%9A%D0%B5%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%88%D0%A0%D0%9F%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2%20%D0%B2%D0%BE%20%D0%BF%D0%B5%D1%80%D0%B8%D0%BE%D0%B4%20%D0%BE%D0%B4%2001.04.-%2030.06.2020%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0.pdf>

<sup>12</sup> [https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020\\_FH\\_NIT2020\\_vfinal.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-04/05062020_FH_NIT2020_vfinal.pdf)

<sup>13</sup> <https://rsf.org/en/north-macedonia>

<sup>14</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/fridem-haus-maqedonia-me-perparim-ne-sektorin-e-mediave-por-ende-ne-grupin-e-vendeve-me-regjime-hibride-te-tranzicionit/>

<sup>15</sup> <https://vlada.mk/node/21115?ln=mk>

<sup>16</sup> <https://ssnm.org.mk/>

<sup>17</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/qeveria-dhe-sindikata-e-gazetarëve-s-paitohen-per-raportin-e-reportereve-pa-kufij/>

<sup>18</sup> [http://www.stat.gov.mk/pdf/2020/2.1.20.19\\_mk.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/2020/2.1.20.19_mk.pdf)

<sup>19</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/vitin-e-kaluar-11-radiodifuzere-te-vendit-kane-transmetuar-me-pak-program-ne-televizion-dhe-radio/>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### **Observatori i reformave në media**

ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (LSHAAM), të cilat u miratuan nga kuvendi në shkurt të këtij viti. Operatorët në vend paralajmëruan se do të fillojnë me ndërprerje të përkohëshme të riemitimit të kanaleve vendore dhe të huaja, me përjashtim të RTM-së dhe në qoftë se urgjentisht nuk ndryshohet diçka, do të ndërprejnë në tërësi shërbimet për riemitim të përmbajteve televizive nga oferta e tyre dhe do të shkaktojnë terr mediatik. Vendimit të këtillë iu bashkangjiten<sup>20</sup> edhe operatorët më të mëdhenjë A1 dhe Telekom. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme e cila u shpall përshkak të korona-krizës, qeveria e shfrytëzoi të drejtën e saj ligjore dhe me dekret i obligoi<sup>21</sup> operatorët që të riemitojnë programet televizive. Mbetet të ndiqet zhvillimi i ngjarjeve në këtë temë në raportet e ardhëshme periodike të ORM, sepse pas këtij gjesti të qeverisë nuk kishte ngjarje të tjera dhe vendime në lidhje me operatorët kabllovik dhe kërkesat e tyre.

#### **1.1 Zgjedhjet e parakohëshme parlamentare**

Në kuadër të këtij raporti periodik monitorues ORM2 i ka ndjekur edhe shkrimet, rethanat dhe reagimet lidhur me sferën mediatike gjatë fushatës parazgjedhore dhe zgjedhjeve.

Analizat<sup>22</sup> gazetareske tregojnë se lajmet e rreme dhe vetregullimi janë pjesa më e shprehur për mediat e programet e të dyja partive më të mëdhaja politike dhe oponent të ndërsjellë (LSDM dhe OBRM-PDBNM). Kur bëhet fjalë për radiodifuzerin publik, në analizat e programeve partiake konstatohet se<sup>23</sup> LSDM e sheh RTM-në si mbrojtës nga dezinformatat, derisa OBRM-PDBNM në programën e saj i referohet nevojës për ligj të posatshëm (lex specialis) për RTM-në për të cilin thot se në qoftë se vijnë në pushtet do ta miratojë. Para fillimit të fushatës u analizua<sup>24</sup> edhe legjislativa e procesit zgjedhorë, e cila rezultoi se ka lëshime ndaj definimit të heshtjes zgjedhore nga ana e KSHZ.

Në fillim të periudhës parazgjedhore ASHAAM si trup rregullator kompetent kumtoi se kan miratuar metodologjinë<sup>25</sup> për monitorim të përfaqësimit mediatik për zgjedhjet e parakohëshme parlamentare në vijim, deri sa radiodifuzeri publik nacional për kanalin e parë programor i publikoi<sup>26</sup> rregullat e tyre për mbulim mediatik. Agjencia ua ndërmendëte mediave edhe për rregullat gjatë njoftimit për zgjedhjet, gjegjësisht, ua rikujtoi<sup>27</sup> radiodifuzerëve se rezultatet nga hulumtimi i opinionit publik në lidhje me zgjedhjet, në bazë të Kodit Zgjedhor, mund të publikohet më së voni pesë ditë para datës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, respektivisht më se voni deri në ora 24 të 9 korikut të vitit 2020. Për më tepër, agjencia në pajtim me kompetencat e saja ligjore kahëzoi vëmendjen<sup>28</sup> ndaj rregullave për njoftim në periudhën e heshtjes parazgjedhore. Gjatë këtyre zgjedhjeve u konstatuan thyerje të heshtjes parazgjedhore më së shumti nga ana e online mediave për të cilat kishte reagime të ashpra<sup>29</sup> nga ana e shoqatave mediatike. Për thyerje të heshtjes parazgjedhore agjencia informoi<sup>30</sup> në disa raste<sup>31</sup>. Ajo, gjithashtu, reagoi

<sup>20</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/a1-dhe-telekomi-iu-bashkengjiten-protestes-nga-e-diela-te-gjithe-operatorete-me-nderprerje-te-perkohshme-ne-programin-tv/>

<sup>21</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/me-dekret-qeveria-u-percaktoi-operatoreve-detyrim-per-te-riemituar-programet-televizive/>

<sup>22</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/lajmet-e-rreme-dhe-vete-rregullimi-ne-fokus-te-programeve-te-vmro-dpmne-se-dhe-lsdm-se-pjesen-per-mediat/>

<sup>23</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/rtmv-ne-programet-zgjedhore-lsdm-e-sheh-ate-si-nje-mbrojtes-nga-dezinformatat-vmro-do-ta-rregulloje-ate-me-nie-ligi-te-ri/>

<sup>24</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/propagande-partiake-ne-diten-e-zgjedhjeve-ne-mungese-te-heshtjes-zgjedhore/>

<sup>25</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmav-e-miratoi-metodologjine-per-monitorimin-e-mbulimit-mediatik-per-zgjedhjet-e-ardhshme/>

<sup>26</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/rtm-ja-i-publikoi-rregullat-per-mbulim-mediatik-te-zgjedhjeve-mirepo-vetem-per-servisin-e-pare-programor/>

<sup>27</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/rezultatet-nga-sondazhet-zgjedhore-mediat-mund-t-i-publikojne-me-se-voni-deri-me-9-korrik/>

<sup>28</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmaa-nga-e-diela-ne-mesnate-fillon-heshtja-zgjedhore/>

<sup>29</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/shgm-dhe-kemm-e-denojne-shkelien-direkte-te-heshtjes-zgjedhore-prej-disa-mediave-online/>

<sup>30</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmaa-telma-dhe-alsat-m-e-kane-shkelur-heshtjen-zgjedhore-apel-qe-te-raportohet-me-pergjegjesi/>

<sup>31</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmav-edhe-programi-i-pare-i-radiotelevizionit-te-maqedonise-dje-e-ka-shkelur-heshtjen-zgjedhore/>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### ***Observatori i reformave në media***

për informimin e pabalansuar<sup>32</sup> të dy shtëpive televizive për të cilat kërkoi<sup>33</sup> shqiptim të dënimeve prej 4 mijë euro në procesin e zbatuar për kundërvajtje. Para se të ndodhin këto reagime të ASHAAM, partia politike BDI për herë të parë parashtrroi ankesë te ASHAAM në të cilën reagoi për organizimin e emisioneve debative në programet e shtëpive televizive.

Raporte të tyre, për mënyrën, profesionalizmin dhe cilësinë me të cilat mediat mbuluan fushatën parazgjedhore dhe zgjedhjet publikuan ASHAAM dhe misioni i OSBE/ODIHR. Për ASHAAM konstatimi kyç ka të bëjë me televizionet komerciale për të cilët referoi<sup>34</sup> se te ata theksi në mbulimin e zgjedhjeve ka qenë mbi dy koalicionet “Mundemi” dhe “Rimëkëmbja për Maqedoninë”. Në raportin e ASHAAM më së shumti theksohen rezultatet nga monitorimi i programeve televizive, ndërsa më pak vëmendje i është kushtuar ndjekjes së radiostacioneve. Në raportin nga monitorimi i OSBE/ODIHR<sup>35</sup> vëmendje më e madhe i kushtohet RTM-së, për të cilin konstatohet<sup>36</sup> se në mënyrë të përpiktë i është përmbajtur Kodit Zgjedhor. Për televizionet komerciale misioni monitorues i OSBE/ODIHR konstaton<sup>37</sup> se te ata nuk ka patur mbulim të mirëfilltë analitik dhe se në programet e tyre informative kanë mbuluar aktivitetet e fushatës së pjesëmarrësve në procesin zgjedhorë në mënyrë sipërfaqësore.

<sup>32</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmaa-kerkon-procedure-kundervajtese-kunder-alsat-m-dhe-shenja-nuk-kane-informuar-ne-menyre-te-balancuar-gjate-fushates-zgjedhore/>

<sup>33</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/ashmaav-kerkon-denime-prej-4-000-euro-per-alsat-m-dhe-shenja-per-raportim-te-jo-balancuar-ne-fushate/>

<sup>34</sup> <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/07/%D0%A4%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%BE%D0%B4-%D0%9F%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B8-2020.pdf>

<sup>35</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/8/2/457426.pdf>

<sup>36</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/odihr-rtvm-i-ka-respektuar-dispozitat-e-kodit-zgjedhor-per-raportim-gjate-fushates-zgjedhore/>

<sup>37</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/osbe-odihr-radiodifuzeret-nacional-nuk-kishin-raportime-te-hollesishme-analitike-gjate-fushates/>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### Observatori i reformave në media

## 2. Reklamimi qeveritar/paratë publike në media

Në pajtueshmëri me RUP, në fushën „reklamimi qeveritar“ RMV duhet të përmbush si vijon:

- „të vendosen rregulla të rrepta për reklamimin qeveritarë të bazuara në kriteret transparente, objektive dhe jodiskriminuese;
- të sigurohet transparencë e plotë e reklamimit qeveritar (jo vetëm në aspekt të harxhimit të parave publike, por edhe në aspekt të pranuesit të mjeteve dhe përmbajtjeve);
- të zhvillohet mekanizëm për publikime të papaguara në shërbimin publik të cilat me të vërtetë janë interes publik“.

Pjesërisht e  
realizuar

Në fillim të qershorit u realizuan paralajmërimet për ndihmë shtetërore ndaj mediave për shkak të gjendjes së përkeqësuar ekonomike e shkaktuar nga Korona-kriza. Shteti shprehu gadishmëri për të ndihmuar këtë sektor në periudhën kur për në më pak se një muaj duhej të mbahen zgjedhjet e parakohëshme parlamentare të cilat u shtynë nga data e përcaktuar paraprakisht në mars të këtij viti. Për këtë qëllim qeveria ndau gjysëm million euro për radiodifuzerët<sup>38</sup> për përballjen me pasojat e Korona-virusit. Ndaj këtij vendimi reagon<sup>39</sup> shoqatat mediatike me arsyetimin se ndihma qeveritare është selektive dhe nuk i përfshinë të gjitha mediat. Në fakt, ndihma qeveritare nuk i përfshinte radiodifuzerët lokal dhe regional të cilët gjithashtu kërkuan të jenë pjesë e subvencioneve qeveritare për tejkalimin e krizës ekonomike për shkak të pandemisë. Ata paralajmëruan grevë<sup>40</sup> në shenjë të pakënaqësisë nga qasja e tillë selektive. Për më tepër, ndaj këtij vendimi të qeverisë pakënaqësinë e tyre e shprehën edhe nga IZHKE të cilët angazhohen që televizionet kablloviqe dhe satelitore që nuk emetojnë sinjal terestrial të marin subvencione. Ndaj këtyre reagimeve MSHIA doli me kumtesë<sup>41</sup> në të cilën thuhej se nuk është bërë seleksionim dhe informuan se ASHAAM të gjithë mediave nuk do të ua faturojë të dhënat për leje për emitim për vitin 2020. Gjithashtu informuan se të gjitha mediat në mënyrë të barabartë përfitojnë subvencion prej 14.500 denarë për çdo të punësuar. Si plotësim të ndihmës shtetërore ndaj mediave në bazë të vendimit të qeverisë, SPGPM duke i përshëndetur masat e deritanishme kërkoi paket-masa plotësuese<sup>42</sup> të cilat do të ishin në drejtim të ndihmës dhe mbrojtjes plotësuese individuale, të punëtorit dhe sindikale për gazetarët dhe profesionistët mediatik. Si plotësim të këtyre kërkesave të SPGPM, qeveria në seancën e mbajtur në 10 qershor mori vendim<sup>43</sup> me të cilin subvencionohen kontributet për të gjithë të punësuarit në media për muajt qershor, korrik dhe gusht të vitit 2020. Subvencionimi i kontributeve i cili u implemetnua nëpërmes të DAP<sup>44</sup> u kushtëzua<sup>45</sup> me 3 kushte: të kthehen në nivelin paraprak rrogat e zvogëluara nëse ka raste të tilla; të mos kenë punëtorë të pushuar nga puna gjatë kohës së krizës dhe të kenë më së paku 3 të punësuar në kohë të pacaktuar. Si shtesë në paketin e masave edhe ndërmarja publike RDSH me urdhër të qeverisë nuk do të ua faturojë harxhimet për sigurimin e furnizimit energjetik për pajisje radiodifuzive për vitin 2020 dhe harxhimet për qira të hapësirave të objekteve radiodifuzive të NP RDSH për vitin 2020.

<sup>38</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/pas-televizioneve-edhe-radiot-fituan-ndihme-qeveritare-per-perballje-me-virusin-korona/>

<sup>39</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/shgm-dhe-spgpm-dekreti-i-qeverise-per-ndihme-mediave-eshte-selektiv-dhe-nuk-i-perfshin-te-gjitha-mediat/>

<sup>40</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/stacionet-televizive-rajonale-dhe-lokale-nga-sot-kane-hy-ne-greve-edhe-ata-po-kerkojne-ndihme-nga-qeveria/>

<sup>41</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/mshia-nuk-eshte-bere-diskriminim-ne-ndihmen-e-mediave-te-prekura-nga-kriza-e-korones/>

<sup>42</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/spgpm-nevojitet-pakete-masash-per-te-ndihmuar-gazetarët-dhe-punëtorët-e-mediave/>

<sup>43</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/qeveria-per-tre-muaj-do-te-subvencioje-kontributet-sociale-per-punonjesit-e-mediave/>

<sup>44</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/dap-mediat-mund-te-aplikojne-per-subvencionim-te-kontributeve-nga-sigurimi-obligativ-social/>

<sup>45</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/qeveria-me-tre-kushte-deri-te-mediat-per-subvencionet-per-kontributet-e-pages/>



Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### Observatori i reformave në media

### 3. Qasja te informatat


Për fushën “Qasja te informatat me karakter publik”, në kuadër të RUP, kërkohet:

„të adresohen pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen gazetarët gjatë marrjes së informatave publike (për shembull, pamundësia e trupave relevant të përgjigjen në shumë kërkesa për informata, përdorja e tepërt dhe e paarsyeshme e kategorisë ‘konfidencial’ për dokumente të cilat nuk janë të asaj natyre)“.

Tërësisht e  
realizuar

Edhe pse në çerekun e parë të vitit 2020 Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje te informatat me karakter publik iu përgjigj të gjitha ankesave të prapambetura dhe tani më funksionojnë me kompetenca të plota, përsëri pjesa më e madhe e gazetarëve ankohen për jo transparencë të institucioneve. Për heshtje të institucioneve ankohen<sup>46</sup> punonjësit mediatik të cilët meren me gazetari hulamtuese, por edhe SHGM. Nga SHGM informojnë se në të ardhmen do të përkushtojnë më shumë vëmendje ndaj transparencës së institucioneve në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme dhe krizës shëndetësore, sepse duan që të përjashtojnë mundësinë që dikush të keqpërdorë situatën dhe të mshef informata me interes për qytetarët.

Numri mesatar i ditëve për të cilët janë përgjigjur kërkesave për qasje



Qendra për komunikime qytetare (QKQ) konstaton se institucioneve iu duhen 25 ditë që të përgjigjen në kërkesat për qasje të lire te informatat me karakter publik. Në indeksin e tyre për transparencë aktive<sup>47</sup> të vitit 2020 ata kanë matur transparencën e ministrive dhe të komunave në të cilat sipas matjeve të tyre, duket se institucionet e tejkalojnë afatin 20 ditore për përgjigje ndaj kërkesave për qasje. Analizat<sup>48</sup> e mëtejme të këtij Indeksi tregojnë se te ministrinë zvogëlohet numri i ditëve të pritjes krahasuar ndër vite

nga 2018 deri 2020, ndërsa te komunat koha e pritjes po zgjatet.

Drejtoresha e agjencisë në intervistë për meta.mk deklaroi se mbeten të hapur për bashkëpunim me të gjithë, por thekson se kriza me Covid 19 krijon hapësirë për vonesa gjatë përgjigjeve të institucioneve të cilat posedojnë informata<sup>49</sup>. Nga përgjigjet në pyetësorin anketues të cilin agjencia e ka dërguar te të gjitha institucionet të cilat posedojnë informata me karakter publik, konstatohet se përsëri aryeja kryesore për pamundësinë e qasjes te informatat është “heshtja e menaxhmentit” me 34 kërkesa të përgjigjura, respektivisht veprim të poseduesëve pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj. Pa marrë parasyshë fotografinë jo të plotë statistikore, numri prej 34 kërkesave që janë ballafaquar me “heshtje të menaxhmentit”<sup>50</sup> është tregues i mjaftueshëm se agjencia në periudhën që pason duhet të fokusohet në punën e transparencës te persona të caktuar zyrtar, respektivisht posedues të informatave.

<sup>46</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/gazetaret-hulamtues-ankohen-per-jotransparencen-e-institucioneve/>

<sup>47</sup> <https://www.opendata.mk/Storage/Indeks-na-aktivna-transparentnost-2020.pdf>

<sup>48</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/institucioneve-ne-rmv-u-nevoijten-25-dite-per-t-iu-pergjigjur-kerkesave-per-qasje-te-lire-tek-informatat/>

<sup>49</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/pllamenka-bojceva-iemi-te-hapur-per-bashkepunit-per-mbrojtje-te-qasjes-se-lire-tek-informatat-me-karakter-publik/>

<sup>50</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sq/arsyeja-krvesore-per-te-mos-pasur-qasje-ne-informacione-eshte-heshtja-e-administrates/>



Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### **Observatori i reformave në media**

#### **3.1. Shpifja**

Reformat prioritare në media në fushën e katërt 'shpifja' parashohin:

„...zvogëlim i numrit të rasteve të shpifjes të cilët mbërijnë në gjyqe, gjë e cila duhet të arihet nëpërmes: revidimit të legjislativës që të hiqen rastet e llojit 'nderë', 'dinjitet' dhe 'ofendim', të cilët inicohen në pajtim me definicionin ligjor për ofendim, por që janë jashtë përfshirjes së ofendimit në kuptimin e nenit 10 nga Konventa Europiane për Mbrojtjen s të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); revidimi i regullave procedurale për përjashtim të rasteve të vogla, dhe në vend të tyre të ketë ritje të aplikimit të ndërmjetësimit gjatë zgjidhjes së tyre; mbështetje dhe promovim të shfrytëzimit më të shpeshtë të vetregullimit si alternativë për procesimin gjyqësor; garantim dhe implementim të nivelit politik për përdorim të përshtatshëm të vetkufizimit nga ana e politikanëve dhe funksionarëve publik me qëllim që të mos inicohet proces për shpifje, në pajtim me parimet e Gjyqit European për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)“.

E filluar, por  
e përealizuar

Në këtë periudhë të vëzhgimit të aktiviteteve lidhur me shtyllën e katërt të RUP, gjegjësisht të reformave ligjore për shpifje dhe ofendim nuk ka asnjë lëvizje krahasuar me raportin e vëzhgimit të çerekut paraprak<sup>51</sup> të ORM, në të cilin u shënuan aktivitete përgatitore në Ministrinë e Drejtësisë në RMV. Nga atje për meta.mk informojnë<sup>52</sup> se përshkak të krizës globale me Korona-virusin Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektsh (ZKBSHP) e ka shtyrë deri në fund të shtatorit përpilimin e analizës për zbatimin e Ligjit për Përgjegjësi Qytetare për Shpifje dhe Ofendim.

Përshkak të ngecjes së tillë, nga ana tjetër u intensifikuan dhe shpeshtuan etiketimet dhe shpifjet ndaj gazetarëve. Nga SHGM informojnë<sup>53</sup> se numri i sulmeve verbale dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve është në ritje, edhe atë në kushte kur dy vitet e fundit është shënuar rënie e numrit të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Brengos e dhëna se shumica e sulmeve verbale dhe kërcënimeve këtë vit janë ndaj gazetarëve dhe por edhe fakti se një pjesë e etiketimeve<sup>54</sup> vijnë nga bartës të funksioneve publike.

<sup>51</sup> [https://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2020/07/OMR\\_izvestaj2\\_1.1.02.20-30.4.20FINAL.pdf](https://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2020/07/OMR_izvestaj2_1.1.02.20-30.4.20FINAL.pdf)

<sup>52</sup> <https://mediaobservatorium.mk/korona-krizata-ja-odlozhi-do-septemvri-izrabotkata-na-noviot-zakon-za-graganska-odgovornost-za-navreda-i-kleveta/>

<sup>53</sup> <https://mediaobservatorium.mk/sg/zgjedhjet-po-afrohen-sulmet-verbale-dhe-kercenimet-ndaj-gazetarëve-po-shtohen/>

<sup>54</sup> <https://mediaobservatorium.mk/znm-bara-ali-ahmeti-kako-pretседател-na-vladejachkata-dui-da-prestane-so-etiketirane-na-novinari/>

Projekti është i financuar nga Fondacioni  
Shoqëri e Hapur - Maqedoni

### ***Observatori i reformave në media***

#### Literatura e shfrytëzuar

- Przino Agreement – Agreement in Skopje to overcome political crisis, 2 June 2015, Skopje.
- Reformat urgjente prioritare për Republikën e Maqedonisë, Komisioni European, Politika e fqinjësisë së mirë dhe negociatat për zgjerim, Qershor 2015.
- Programi për punën e Qeverisë së RM 2017-2020.
- Plani “3-6-9” i Qeverisë së RM, 2017-2018.
- Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in spring 2015.
- Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues, 2017.